



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nen.c) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040 nenit 40 paragrafi 40.2 nën 3) të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 3 të Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Klinës 01Nr. 06-2735/2016 të dt. 01.06.2016 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarje të 20 bursave për Student të Komunës së Klinës 01 Nr.06-348/2016 të dt.29.01.2016, me kërkesën e drejtorisë së Arsimit, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX të radhës për vitin 2016, të mbajtur më 31.10.2016, mori këtë:

V E N D I M
P Ë R

Formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës për vitin akademik 2016/17

- I. Miratohet vendimi për Formimin e Komisionit për ndarje të bursave për studentët e Komunës së Klinës për vitin akademik 2016/2017.

Formimi i Komisionit behët pas mbylljes së Konkursit 04 Nr.111-4230 të dt.6/10/2016
- II. Formimi i Komisionit si në pikën 1 të këtij Vendimi përbëhet nga 5 anëtarë:
 1. Ndue Shabanaj
 2. Arben Limanaj
 3. Zeqir Morina
 4. Bedri Gashi
 5. Florida Gashi - OJQ
- III. Puna e Komisionit mbështetet në Rregulloren për ndarje të bursave për studentët e Komunës së Klinës, 01Nr.06-2735/2016 të dt. 01.06.2016 si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për ndarjen e 20 bursave për studentet e Komunës së Klinës, 01Nr.06-348/2016 të dt.29.01.2016.
- IV. Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL.
- V. Me këtë Vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit, Drejtoria e Arsimit anëtarët e Komisionit, Zyra për informim, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-4585 2016
Klinë. më 04.11 2016

